



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

KRYETARI

V E N D I M

Nr. 2 Datë 08.04.2021

PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT PARA KOHE TË MANDATIT TË KESHILLTARES TE QARKUT SHKODËR Znj. MARTE FTONI

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2021, në mbështetje të ligjit 139/2015 “për vetqeverisjen vendore” nenit 49 pika b) i ligjit, neni 75 pika c) dhe neni 77 pika j). Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj. Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, ” për vendimmarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19”, si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 “për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...bazuar në Urdhërin nr.633 datë 17.11.2020 “për ndalimin e grumbullimeve me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura...”,

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, pas relatimit nga sekretaria e këshillit të qarkut dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **13 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim.**

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

V E N D O S I

1. Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares së qarkut Shkodër **Znj. Marte Ftoni** si pasojë e humbjes së mandatit si anëtare e këshillit bashkiak Vau – Dejes, si rrjedhojë e dorëheqjes se asaj.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 150/3Prot.

Shkodër me 17.03.2021

RELACION

PËR PROJEKT -VENDIMIN

PËR MBARIMIN E PARAKOHSHEM TË MANDATIT TË KËSHILLTARES TË QARKUT, SHKODËR ZNJ. MARTE FTONI.

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 49 pika b) i ligjit, neni 75 pika c) si dhe neni 77 pika j).

Pranë Këshillit të qarkut Shkodër është përcjellë shkresa zyrtare nr.145 prot. Date:12.03.2021 nëpërmejt të cilës është depozituar Vendimi i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës nr.08 dt:26.02.2021. Me anë të të cilit është miratuar dorëheqja e anëtares së Këshillit Bashkiak Vau-Dejës **Znj. Marte Ftoni**. Bazuar në ligj si pasojë e humbjes së mandatit si anëtare e Keshillit Bashkiak rrjedhimisht e humbet edhe mandatin si anetare e keshillit te qarkut Shkoder.

Si pasoje propozoj te shtohet ne rendin e dites se mbledhjes se KQSH-se edhe Projekt-vendimi per Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të këshilltares së qarkut Shkodër znj. Marte Ftoni si pasojë e humbjes së mandatit si anëtare e këshillit bashkiak Vau – Dejes, kjo si pasojë e dorëheqjes se asaj.

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Edita SHOSHI